



In medias res

FAZAT NËPËR TË CILAT KALOJNË NDRYSHIMET NË ARSIM (2)

“Suksesi i një vendi matet me suksesin e ndryshimeve pozitive në atë vend”

Në analizën dhe revizionin e gjendjes në arsim, të cilin e kemi kategorizuar si fazë të parë të ndryshimeve në arsim ndodhin gjëra të rëndësishme, që përcaktojnë shkallën e ndryshimeve në fazën e dytë, që ne e quajmë fazë të projeksioneve të zhvillimeve strategjike dhe zhvillimore të arsimit.

Po ashtu, në fazën e parë të vlerësimit të shëndetit real të gjendjes së arsimit duhet të ndodhin disa ndryshime rëndësishme në shoqëri, në mënyrë që të kalohet në fazën e projeksionit. Ndër këto ndryshime që duhet të ndodhin veçojmë:

- a. Rritjen e vetëdijes së qytetarëve për rolin dhe rëndësinë që ka arsimit për jetën dhe fatin e tyre, familjes së tyre, kombit dhe të civilizimit në përgjithësi
- b. Krijimi i një mendësie, apo një “metanoie” (greqisht: mendësie re), siç thotë Senge, pa të cilën, siç është thënë edhe më herët nuk ndryshime të suksesshme
- c. Zgjerimi i pronësisë - përkatësisht përhapja e saj në popullsi duke krijuar mundësi për pjesëmarrje sa më aktive të qytetarëve në ndryshime - rritja e gamës së agjentëve të ndryshimit (nxënësve, prindërve, mësimdhënësve, gazetarëve, juristëve, mjekëve, inxhinierëve, avokatëve juristëve, ekonomistëve, ekologëve, bashkësive të ndryshme etnike, gjinore dhe profesionale, të shoqërisë civile)
- d. Rritja e konsensusit për ndryshime
- e. Botimi i Librit të Gjellbër (në të cilën është pasqyruar gjendja objektive “shëndeti real i sistemit të arsimit)

Me këto ndryshime nxiten ndryshime të tjera stimulative për projektimin dhe disejnimin e sofistikuar ndryshimeve të domosdoshme pozitive, sepse, sistemi i arsimit kuptohet si interes nacional i të gjithë qytetarëve, se në mendësinë e re shtohet interesimi i qytetarëve për pjesëmarrje në këto ndryshime me çka rritet “pronësia” dhe përgjegjësia qytetare për ndryshime në arsim; se me plotësimin interesave të qytetarëve zgjerohet mundësia për ndryshime konsensuale, pa arritjen e të cilës nuk ka ndryshime pozitive, as pronësi, as mendësi të re, as vetëdije për atë se arsimimi është interes nacional i secilit qytetarë. Botimi i librit për gjendje e sistemit të arsimit është pjesë e domosdoshme për projektimin e ndryshimeve në arsim.

Ndryshimet në arsim nuk mund të bëhen me “makro-qasje”, përkatësisht me metodën e “kutisë së zezë”, meqë terapia dhe kurimi që duhet të ndodhë në përmirësimin e shëndetit të arsimit nuk mund të ndodhë pa një diagnozë të saktë të pikave të dobëta dhe të forta, mundësive potenciale të shoqërisë, nevojave të qytetarëve dhe të shoqërisë, projeksioneve zhvillimore të vendit, trendeve zhvillimore globale etj.

Të gjitha ndryshimet e deritashme kanë dështuar sepse ato janë bërë pa njohjen e gjendjes reale të arsimit, pa një skanim objektiv të efikasitetit dhe të efektivitetit. Që të fillon ky projektim, në debate që zhvillohen për ‘Librin e gjellbër’ evidencohen nevojat dhe interesimet e qytetarëve dhe të shoqërisë në fusha të ndryshme, që më pas përfshihen në një “Libër të bardhë” për të cilin do shkruhet pasi të trajtohet tema “Projektimi i ndryshimeve në arsim”

Shkroi: Halim Hyseni

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Më 16-17 maj 2009 është mbajtur seminari i shtatë me titull “Planifikimi dhe vlerësimi” për 7 grupe të mësimit të mesimdhënësve që janë duke u trajnuar në kuadër të Programit të MKLSH. Seminari është mbajtur për mësimitdhënësit e Prishtinës (dy grupe), Pejës, Ferizajit, Gjilanit, Gjakovës dhe Mitrovicës. Gjatë këtij seminari, trajnerët kanë theksuar nevojën e mësimitdhënësve për të planifikuar me kujdes njësitë mësimore. Ata kanë theksuar aspektet e ndryshme që mësimitdhënësit duhet të kenë kujdes me rastin e planifikimit, si mënyrën e motivimit të nxënësve për të nxënë, caktimin e objektivave mësimore, përzgjedhjen e teknikave të përshtatshme, zbatimin e formave të ndryshme të vlerësimit etj. Në ditën e dytë të seminarit trajnerët kanë prezantuar matricën e testit dhe mënyrën e përgatitjes së testeve objektive. Në fund pjesëmarrësit kanë përgatitur nga një test në baza lëndore. Pjesëmarrësit janë njoftuar se certifikimi i tyre do të kryhet në qershor.

■ Më 16-17 maj është mbajtur seminari i shtatë dhe i fundit për 36 mësimitdhënës të komunës së Podujevës, të cilët janë duke e vijuar trajnimin e MKLSH me vet financim. Certifikimi i këtyre mësimitdhënësve është paraparë të bëhet në muajin qershor.

■ Në kuadër të Programit “Metodologjitë e reja dhe të nxënimit ndërveprues”, KEC në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe DKA e Prizrenit kanë trajnuar gjatë muajit mars dhe prill 125 mësimitdhënës të Prizrenit, 24 të Suharekës dhe 64 mësimitdhënës të Mitrovicës. Pas përfundimit me sukses të trajnimit, më 3 maj është bërë certifikimi

i mësimitdhënësve të Prizrenit dhe Suharekës, ndërsa më 10 maj i atyre të Mitrovicës.

Krijimi i mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla

■ Gjatë këtij muaji është hapur konkursi për hartimin një eseje në temën: “Dashura mund Dhunën”. 49 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta, kanë marrë në këtë konkurs.

Nga 49 ese të shkruar, janë përzgjedhur tri esetë më të mira të cilat do të publikohen në manualin: “Ndal Dhunën - Krijë Mjedise të Sigurta dhe Miqësore për fëmijë”.

Nxënësit fitues janë shpërblyer me nga 250 Euro.

■ Në Galerinë e Arteve të Kosovës është organizuar Ekspozita shtatë-ditore e punimeve të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta në temën në temën: “Ndal dhunën- Krijë Mjedise Miqësore për Fëmijë”



Më këtë rast janë shpërblyer 5 nxënës me nga 150 euro. Punimet më të mira të cilat po ashtu do të publikohen në manualin e përmendur

Hap pas Hapi

■ Gjatë muajit prill dhe maj, janë zhvilluar një seri trajnimesh. Të gjithë pjesëmarrësit që gjatë këtyre muajve morën pjesë në trajnime, janë obliguar të planifikojnë dhe realizojnë punën e tyre për një muaj. Prezantimet e planifikimeve mujore të realizuara dhe dosjet e vëzhgimit dhe vlerësimit të nxënësve varësisht nga trajnimi në të cilin morën pjesë, ishin kusht për certifikim.

Prezantimet u realizuan me këtë orar:

Prishtinë, klasa e dytë(grupi I), 28 prill

Gjilan, klasa e dytë, 26 prill

Istog, klasa e parë fillestar, 25 prill

Prishtinë, klasa e dytë (grupi II) 25 prill

Prishtinë, klasa e dytë (grupi III), 25 prill

Prishtinë, klasa e parë avancues) 29 prill

Gjakovë, klasa e katërt (grupi I) 25 prill

Gjakovë, klasa e katërt (grupi II) 26 prill

Prishtinë, klasa e katërt, 22, 23 maj

Prishtinë, klasa e dytë, 23 maj

Po ashtu u zhvilluan edhe dy trajnime për klasën e katërt dhe tretë në Prishtinë.

Trajnimi për klasën e IV u mbajt me datat 17-19 prill, ndërsa për klasën e III me 18-20 prill.

KOSOVISION Contest

■ Gjatë këtij muaji, të gjitha shkollat përfunduan punën e tyre me projektet shkollore. Angazhimi i tyre në përfundimin dhe dokumentimin e projektit ishte jashtëzakonisht i madh.

Pas dokumentimit të projektit, ekipi vlerësues i projektit KOSOVISION CONTEST bëri vlerësimin e 51 projekteve të klasave të pesta dhe zgjodhi 14 klasa fituese. Shpallja e fituesve u bë më 16 Maj në Pallatin e Rinisë me një pjesëmarrje

me rreth 400 mysafirë. Fituesit e këtij projekti ishin shkollat: “**Emin Duraku**”, në Prizren, “**Shkëndija**” në Suharekë, “**Selman Riza**” në Fushë Kosovë, “**Shotë Galica**”, në Runik të Mitrovicës, “**Fan Noli**”, në Kamenicë, “**Ditura**”, në Zllatar-Ferizaj, “**Isa Boletini**”, në Rahovec, “**Jeta e Re**”, në Komoran-Drenas, “**Bajram Curri**”, në Istog, “**Selami Hallaqi**”, në Gjilan, “**Emin Duraku**”, në Kaçanik, “**Naim Frashëri**”, në Kozaricë-Obiliq, “**Engjell Gjoni**” në Novosellë të Ulët-Gjakovë dhe “**Lidhja e Prizrenit**”, në Pejë.



Të gjitha klasat të cilat kanë bërë projektet shkollore janë pajisur me diploma, ndërsa 14 klasat fituese kanë marr dhuratë me shumë prej 500€ për të organizuar ndonjë ekskursion.



Ministri i Arsimit, Z. Enver Hoxhaj, vlerësoi lart arritjet dhe punën e fëmijëve në projekt. Ministri fuqishëm premtoi për përkrahje të mëtejme të projektit edhe për gjeneratat e ardhshme.

Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit

■ Në kuadër të projektit “Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e edukimit”, financuar nga Komisioni Evropian, aktivitetet janë duke u zhvilluar sipas dinamikës së projektit. Këtë muaj janë mbajtur takimet me drejtorët e shkollave nga komunat e Fushë Kosovës, Prizrenit dhe ajo e Dragashit. Të gjithë drejtorët e shkollave e mirëpritën këtë projekt me shpresë se vërtetë ky projekt do të sjell rezultate dhe përmirësim të gjendjes së të drejtave të fëmijës. Tani janë duke u definuar edhe monitoruesit e brendshëm të shkollave, pra ata të cilët do të jenë në kontakt me monitoruesit e jashtëm të projektit. Pritet që shumë shpejt të zgjidhen edhe 30 shkollat e grupit të kontrollit, pra 15 nga regjioni i Prishtinës dhe 15 nga regjioni i Prizrenit. Edhe këto shkolla do të zgjidhen me ndihmën e Drejtorive Komunale në Komunat përkatëse ashtu edhe si është bërë zgjedhja e shkollave të grupit të synuar.

■ Në kuadër të projektit po ashtu ka pasur edhe aktivitete tjera. Është mbajtur punëtorja dy ditore në “Vila Gërmia” në Prishtinë. Punëtorja ka pasur për qëllim që të fillojë hartimin e një kornize të monitorimit për gjendjen e të drejtave të fëmijës në shkolla.



Në punëtori morën pjesë rreth 23 persona të cilët dhanë kontribute për

hartimin e kësaj kornize. KEC do të zhvillojë instrumentet për monitorim dhe prezantimi i tyre do të bëhet me vazhdimin e punëtorisë e cila do të jetë një ditore, diku në muajin korrik ku edhe do të dalim me kornizën e përfunduar të monitorimit.

Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim

Gjatë këtij muaji ka filluar zbatimi i projektit dyvjeçar “Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim”, i financuar nga Komisioni Evropian me seli në Bruksel dhe Instituti për Shoqëri të Hapur (OSI) në Budapest.

Ky është një projekt regional, ku organizatë implementuese është Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), ndërsa partnerë janë: Fondacioni i Shoqërisë së Hapur, Shqipëri; ProMente – Hululumtim social, Bosnjë dhe Hercegovinë; Rrjeti i Qendrave për Politika Arsimore (NEPC), Kroaci; Grupi MOST, Serbi; Qendra për Arsim 2000+, Rumuni.

Projekti do të merret me avancimin e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të pakicave etnike në sistemet e arsimit në shtetet e Ballkanit Perëndimor duke i promovuar praktikat e mira dhe duke i përkrahur iniciativat lokale. E gjithë kjo do të bëhet në kuadër të objektivës së përgjithshme të projektit, e që është “të kontribuohet në ndërtimin e sistemeve arsimore gjithëpërfshirëse në shtetet e Ballkanit Perëndimor që promovojnë qasje të barabartë në arsimin cilësor për të gjithë dhe janë model për respekt ndaj diversitetit etnik.

Rezultatet e pritshme të projektit janë:

1. Rrjeti funksional regional për avancimin e gjithëpërfshirjes arsimore është ndërtuar

2. Informata relevante mbi pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grupeve të pakicave etnike në nivel shkolle janë në dispozicion
3. Praktikrat e mira për sigurimin e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit janë mbledhur dhe shpërndarë
4. Iniciativat lokale për përmirësimin e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit janë inkurajuar

Prevention on Peer Violence

■ Në kuadër të këtij projekti ka pasur mjaft aktivitete. Të gjitha shkollat kanë përfunduar me sukses punëtoritë e tyre. Këtë e arritën edhe me ndihmën e grupit të psikologëve të cilët kanë ndihmuar trajnerët për mbarëvajtje sa më të mirë të projektit. Të gjitha shkollat kanë raportuar për punën e tyre. Tani shkollat kanë filluar me mbajtjen e punëtorive edhe me nxënës. Dhe këto punëtori do të mbahen deri në muajin qershor kur edhe përfundon viti shkollor, ndërsa faza e dytë e projektit do të vazhdoj në shtator të vitit 2009.

Access Microscholarship Program

Programi ACCESS në Prishtinë po vazhdon sipas orarit të paraparë. Së shpejti pritet të mbahet një aktivitet social me fëmijët e të tri grupeve Access.

Programi Access në Prizren është duke vazhduar në objekte të reja, gjegjësisht në sallën e trajnimeve të "Akademisë së Trajnimeve dhe Asitencës Teknike", për t'iu përshtatur orarit shkollor të nxënësve. Aktiviteti kryesor që është duke u zhvilluar është me stafin e redaksisë së gazetës së KFOR-it "Dritarja". Nxënësit janë duke shkruar tregime dhe njëkohësisht janë duke mësuar të fotografojnë, gjersa tregimi edukativ i tyre, i përcjellë përmes fotografive, do të botohet në revistën "Dritarja" në formë të foto-tregimit në tri vazhdime. Qëllimi këtij aktiviteti është që Kosovës t'i jepet mesazhi se nxënësit e etnive të ndryshme mund të punojnë së bashku për një të ardhme më të mirë.

Përgatiti: Petrit Tahiri